



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1322 prot.

Tiranë, më 25.08.2025

VENDIM

Nr. 1, Datë 25/08/2025

PËR

HAPJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR 1 (NJË) ANËTAR STUDENT NË
KOMISIONIN ZGJEDHOR TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024; sot më datë 25.08.2025, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UART,

VENDOSI:

- Hapjen e procedurave për zgjedhjen e 1 (një) anëtari, nga rradhët e studentëve, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Arteve të Bukura (KZFAB).
- Studentët e Fakultetit të Arteve të Bukura vetëkandidohen duke dorëzuar aplikimin në sekretarinë e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në datat **26, 27 dhe 28 Gusht 2025, nga ora 10:00 – 12:00.**
- Ky vendim i përcillet Fakultetit të Arteve të Bukura për marrjen e masave për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Orges Malaj

Kryetar



Shpëtim Kërçova

Anëtar

Suela Agolli

Anëtar

Adela Kusuri

Anëtar

Sara Caca

Anëtar

Redjan Mulla

Sekretar